

**P.nr.3747/18**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtares ligjore Valmire Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit D.U., nga fshati T. Komuna e P.1, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 tëKPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4255/18 të datës 30.08.2018, jashtë seancës, me datë 10.10.2018, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 4255/18 të datës 30.08.2018 për shqiptimine urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

**I akuzuari;**

**D.U.**, i ati N., i lindur mëdt: ..., në fshatin T., Komuna e P.1, me numër personal ..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, me datën 20/07/2018, rreth orës 19:30, në rrugën e U. –së, përballë Komunës së P.2 në P.3 i pandehuri D.U. derisa ka qenë duke drejtuar automjetin –autobusin e tipit ‘‘Setra’’, me targa ..., ka vepruar në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit mbi Rregullat e Trafiku Rrugor, duke rrezikuar jetën e njerzeve nuk i ka shmangur rrezikut ndaj pjesmarrësve në trafik, ashtu që derisa e dëmtuara B.Sh. ka qenë duke zbritur në shkallën e fundit tek dera e pasme ka pësuar ndrydhje të indëve të buta në regjionin e djathtë të gjoksit, regjionin e krahut dhe dhe të shpatullës së djathtë dhe regjionin i jorokërbishtor që si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shendetin.

**-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

### **DËNIMIN ME GJOBË**

Nëshumë prej **260(dyqind e gjashtëdhjetë) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se ipandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**Edëmtuara:** B.Sh. nga fshati H., Komuna e P.2 lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.4255/18 të datës 30.08.2018, kundër D.U. nga fshati T. Komuna e P.1, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, teakuzuarit sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit A.G. e datës 10.08.2018, Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.N.U. të datës 11.08.2018, Deklarta e të dëmtuarës, Deklarta e të pandehurit, Raporti i aksidentit, Kallëzimi Penal, skicat e vendit të ngjarjes, fotodokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm-Penal  
P.nr.3747/18 të dt:10.10.2018

**Zyrtare Ligjore,**  
Valmire Ahmetaj

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

### **KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.